



VENDIM

Nr.97 Datë 28.07.2015

**PËR
RINOVIMIN E LIÇENCËS SË SHOQËRISË YLLIAD SH.P.K.
NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 108, DATË 22.12.2010.**

Në mbështetje të neneve 16 , 20 pika b, dhe 110 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4 pika 1 gërma “g” dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.07.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k. për rinovimin e liçensës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtoria Juridike,

Konstatoi se:

1. Shoqëria “YLLIAD” sh.p.k ka aplikuar për rinovimin e liçensës nr. 111, Seria T10 në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike në datën 13.05.2015, në zbatim të Ligjit nr. 9072, datë 23.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar. Bordi i ERE-s me vendimin nr. 74, datë 08.06.2015, miratoi fillimin e procedurave për rinovimin e liçensës së shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 22.12.2010.
2. Në datën 15.05.2015 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
3. Në Ligjin nr 43/2015, neni 110 pika 1, është parashikuar që Ligji nr 9072 datë 22.05.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me ligjin nr 43/2015, shfuqizohet.
4. Në Ligjin nr 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” në zbatim të detyrimeve që burojnë nga vete ligji në nenin 39 dhe nenin 108 pika 3 të

tij, në nenin 110 pika 2 të tij parashikohet se : *Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.*

Për sa më sipër dhe duke qënë se aplikimi i shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gërmat “a”; “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të rinovojë liçensën e shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 22.12.2010, për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE

Petrit Ahmeti

Në mungesë dhe me porosi

Adriatik BEGO